

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE

### Neni 1

#### Hyrje

- 1.1. Shoqëria Postare: E ushtron aktivitetin e saj dhe është e licencuar sipas legjislacionit ne fuqi.
- 1.2. Shoqëria Postare: vepron në cilësi të dhënësit të shërbimeve, ndërsa klienti në cilësi të marrësit të shërbimeve.
- 1.3. Në ushtrim të këtij veprimtarie, Shoqëria Postare posedon te gjitha lejet dhe licencat te cilat bazuar ne legjislacionin ne Kosove janë te detyrueshme.
- 1.4. Klienti është i njoftuar me shërbimet, dhe me vullnetin e tij të lirë pranon shërbimet qe Shoqëria Postare ofron sipas termeve dhe kushteve të më poshtme.
- 1.5. PALËT, në pajtime me vullnetin te tyre te ndërsjellët pajtohen të lidhin këtë kontratë dhe Klienti i pranon ofrimin e shërbimeve nga Shoqëria Postare sipas dispozitave të kësaj Kontrate.
- 1.6. Klienti do të krijoj një profil në platformën digjitale të ofruar nga Shoqëria Postare, në bazë të së cilës do të specifikohen dhe përpunohen shërbimet e kërkuara postare dhe të tjera, të cilat nuk janë paraparë shprehimisht me këtë Kontratë. Me qasjen në këtë platforme do të specifikohen të gjitha detajet e bashkëpunimit ndërmjet palëve, si dhe do të gjenerohen kushtet të cilat nuk janë paraparë me këtë Kontratë, si kushte të veçanta të kontratës.

### Neni 2

#### PERKUFIZIME

Shoqëria Postare nënkupton: PRO DEL SH.P.K., me numër unik të biznesit: 811420918, me seli në Rr. Ulpiana, Objekti Donika Nr. 9, Prishtinë, e autorizuar për shërbime postare nga ARKEP.

Klienti nënkupton këtu e ne vijim i referohet shoqërisë tregtare apo personave fizik në këtë kontratë.

Me "Mall" nënkupton mallrat dhe produktet e ligjshme te cilat postohen apo transportohen per llogari te Klientit, të cilat janë në qarkullim juridik të lirë paautorizime të vecanta nga autoritetet shtetore.

Dërgesë nënkupton dërgesën apo mallin e pranuar nga Klienti, e cila mund të jetë objekt i magazinimit, procesimit, paketimit e cila është subjekt i transportimit dhe dërgimit tek Pranuesi, për llogari të Klientit.

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE

Lënde e ndaluar nënkupton këtu e në vijim i referohet substancave, mallrave apo lëndëve përdorimi, posedimi, apo transporti apo qarkullimi i të cilave ndalohet apo kufizohet me ligj apo leje të vecanta.

Cash on Delivery nënkuton të gjitha dërgesave për të cilat Shoqëria Postare duhet të marrë para nga pritësi për llogari të Klientit.

Zona Urbane nënkuton të gjitha adresat të cilat ndodhen brenda qyteteve apo qytëzave të Republikës së Kosovës.

Zona Jo Urbane nënkuton këtu e në vijim i referohet të gjitha adresave të cilat ndodhen në fshatra të Republikës së Kosovës.

Dërgesë e Pranuar nënkupton cdo Mall apo dërgesë e pranuar në dorëzim nga Klienti dhe shpërndarja fizike është realizuar me sukses të Pranuesi si dhe janë arkëtuar paratë sipas faturës shoqeruese lëshuar nga Klienti apo Pranuesi, pranimi i sëcilës evidentohet me letër pranimi.

Letër pranimi nënkupton vërtetimin e lëshuar nga Shoqëria postare me të cilën evidentohet pranimi i dërgesës nga Pranuesi.

Pranuesi nënkupton pranuesin e dërgesës apo mallit sipas porosisë së Klientit.

Dërgese të Pashperndare nënkupton cdo Mall i marrë në dorëzim nga Klienti , që është realizuar shërbimi postar deri në adresën e përcaktuar në faturën shoqeruese , por dorëzimi të pritesit nuk realizohet për cdo lloj arsye.

### **Neni 3**

#### **OBJEKTI I KONTRATES**

- 3.1 Objekt i kësaj kontrate është ofrimi i Shërbime Postare dhe Transporti i dërgesave brenda dhe jashtë vendit me pagesë për të ofruara nga Shoqëria Postare për llogari të Klientit tek Pranuesi.
- 3.2 Objekti i shërbimeve nga Neni 3.1, i kësaj kontrate përfshinë magazinimin, ripaketimin, shpërndarjen, magazinimin paletar, eksportin dhe importin.
- 3.3 Shoqëria Postare merr përsipër të kryejë për llogari të Klientit shërbimet e përcaktuar në pikën 3.1, sipas Kushteve & Termave të kësaj kontrate.
- 3.4 Për dërgesat për jashtë territorit të Kosovës, palët kontraktuese do të arrijnë marrëveshje të veçantë.
- 3.5 Transporti i dërgesave kombëtare të brendshme dhe rajonale (Shqipëri, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut) do të realizohet përmes transportit rrugor, ndërsa transporti i dërgesave ndërkombëtare jashtë rajonit do të bëhet sipas marrëveshjes së veçantë midis Shoqërisë Postare dhe Klientit.

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE

### Neni 4

#### DETYRIMET E SHOQËRISË POSTARE

- 4.1 Shoqëria Postare detyrohet që në bazë të marrëveshjes së vecantë ti sigurojë Klientit shpejtësinë dhe cilësisë maksimale të mundshme për kryerjen e shërbimit të dakorduar.
- 4.2 Marrja dhe dorëzimi i dërgesës, do të bëhet në vendin e përzgjedhur nga Klienti me pëlqimin e tij të orarit 08:15 AM – 15:30 PM nga e HËNA – DIELEË.
- 4.3 Procesi i shpërndarjes do të kryhet brenda një afati kohor të përcaktuar në ofertë nga momenti i marrjes në dorëzim të dërgesave të dërguar nga Shoqëria Postare. Dorëzimi i dërgesave të Pritesi do të kryhet gjithmonë brenda orarit të prej 24 deri në 72 orësh nga momenti i pranimit të dërgesës nga Shoqëria Postare, përveç nëse nuk është specifikuar ndryshe në marrëveshjen e vecantë midis Shoqërisë Postare dhe Klientit.
- 4.4 Për të arritur efikasitetin maksimal në shpërndarjen e dërgesave Shoqëria Postare merr përsipër të telefonoj Pranuesin duke e informuar për dorëzimin e dërgesës. Në rastet kur numri i telefonit dhe/ose adresa nuk është e saktë, atëherë Shoqëria Postare informon Klientin duke kërkuar informacion shtesë, gjithashtu do presë në periudhë kohore prej 5 minutash për ndonjë perditësim të informacionit.
- 4.5 Shoqëria Postare është e detyruar të ruaj sekretin e korrespondencës, si dhe të kujdeset për trajtimin konfidencial të çdo informacioni që merr në lidhje me veprimtarinë e Klientit.
- 4.6 Shoqëria Postare detyrohet të respektoj detyrimin për mbrojtjen e të dhënave të Klientit, në përputhje me kërkesat e ligjit "Për shërbimet Postare & Transporti në RKS" dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- 4.7 Shoqëria Postare merr përsipër të dërgoj Klientit raport ditor përmes email apo mjeteve të tjera të komunikimit mbi statusin e dërgesave.
- 4.8 Varësisht nga oferta e Shoqërisë Postare për ofrimin e shërbimeve, sipas porosisë së Klientit, Shoqëria Postare do të pajisë me Letër Pranim e Pranuesit Klientin.
- 4.9 Shoqëria Postare do të kthejë dërgesën e pranuar nga Klienti pas shpenzime shtesë të Klientit në rast të dhënies së adresës së gabueshme apo jo-ekzistuese të Pranuesit dhe refuzimit të Pranuesit të pranojë dërgesën.
- 4.10 Shoqëria Postare do të kompensojë dëmin për humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e dërgesës e Klientit, të cilin e ka pësuar si rezultat i përgjegjësisë së Shoqërisë në periudhë prej 2 javore pas konstatimit të fajit të Shoqërisë Postare nga autoritet kompetente, deri në vlerën e përcaktuar në faturën e mallit apo dërgesës të deklaruar me rastin e pranimit të mallit nga ana e Shoqërisë Postare.

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE

### Neni 5

#### DETYRIMET E KLIENTIT

- 5.1. Klienti detyrohet të bëjë deklarimin e llojit të mallit apo dërgesës para dorëzimit të tij tek Shoqëria Postare dhe mban përgjegjësi juridike për deklarimin e rrejshëm dhe të pasaktë të tij.
- 5.2. Klienti detyrohet t'i sigurojë Shoqërisë Postare gjithë informacionin e nevojshëm të kërkuar sa i përket kryerjes së shërbimit si adresa ose elemente të tjerë që ndihmojnë në kryerjen e shërbimit.
- 5.3. Klienti mund të kerkojë sigurimin e mallit rast pas rasti në pajtim me legjislacionit e aplikueshëm mbi sigurimin e mallit në udhëtim. Klienti mund të kryejë edhe vetë sigurimin e mallit kur e shikon të arsyeshme. Në cdo rast, sigurimi i mallit mbetet detyrim i Klientit.
- 5.4. Kur malli apo dërgesa është pranuar në postë në gjendje të rregullt nga Klienti, e cila duhet shprehimisht të konstatohet nga Shoqëria Postare, dhe pëson dëmtime të pjeseshme ose tërsore apo humbje, Shoqëria Postare do të kompenzojë dënimin e shkaktuar Klientit me shumën e tërësishme të mallit apo dërgesës që është cekur paraprakisht në faturë.
- 5.5. Paketimi është përgjegjësi e Klientit, i cili duhet të paketojë mallin në mënyrën e duhur duke i u pershtatur specifikave të mallit, përveç nëse nuk është kontraktuar ndryshe midis palëve.
- 5.6. Klienti është përgjegjës për dëmet që rrjedhin si rezultat i mospaketimit të duhur të mallrave të tyre. Klienti heq dorë nga e drejta e dëmshpërblimit për çdo dëmtim që ndodh gjatë transportit si rezultat i të metave në paketim.
- 5.7. Klienti në cdo rast duhet të shoqërojë mallin me faturë tatimore, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje të vecantë nga palët kontraktuese.

### Neni 6

#### DERGESAT E NDALUARA

- 6.1. Shoqëria Postare nuk merr përsipër transportimin e mallrave të ndaluara të cilat janë jashtë qarkullimit të lirë juridik, përkatësisht qarkullimi i të cilave është i kufizuar me ligj.
- 6.2. Dërgesat e ndaluara nga Neni 6.1 i kësaj marrëveshjeje janë por duke mos u kufizuar janë armët e zjarrit, drogat ilegale dhe mallrat e tjera me qarkullim të kufizuar.
- 6.3. Dërgesat nuk përfshijë edhe paratë e gatshme.

## **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE**

- 6.4. Në rast të dyshimit të mallrave nga Neni 5.1, Shoqëria Postare ka të drejtë të kryejë inspektimin e ngarkesave dhe ti lajmërojë menjëherë autoritetit kompetente për zbatimin e ligjit.
- 6.5. Përjashtimisht, Shoqëria Postare mund të kryejë ofrimin e shërbimeve postare për mallra me qarkullim të kufizuar juridik vetëm me leje paraprake të autoriteteve.

### **Neni 7**

#### **PAGESA E SHËRBIMEVE POSTARE**

- 7.1. Kushtet dhe Pagesa e Çmimit për Shërbime nga ana e Klientit do të përcaktohet në ofertën e Shoqërisë Postare apo me marrëveshje të veçantë.
- 7.2. Pagesa e Shërbimeve Postare përjashtimisht mund të kryhet nga Pranuesi, nëse kjo parashihet shprehimisht dhe dakordohen palët.
- 7.3. Pagesën e Shërbimeve Postare do ta bëjë Klienti edhe në rastet e caktuara nga Neni 3.9 i kësaj Kontrate.
- 7.4. Çmimi i shërbimit dhe mënyra e pagesës do të gjenerohet nga platforma digjitale e Shërbimit Postar, e cila duhet të pranohet nga Klienti.

### **Neni 8**

#### **FORCE MAJURE**

- 8.1. Shoqëria Postare nuk mban përgjegjësi për shkaktimin e dëmeve tek Klienti të cilat rezultojnë në shkatërrimin, humbjen apo dëmtimin e dërgesës apo vonesat në realizimin e obligimeve kontraktuese si pasojë e forcës madhore.
- 8.2. Forcë madhore nënkupton tërmetet, vërshimet, zjarret, bllokadat, aktet terroriste apo ngjarjet tjera jashtë kontrollit të palëve kontraktuese të cilat nuk mund të shmagen megjithë kujdesin e palëve.

### **Neni 9**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE LIGJI I APLIKUESHËM**

- 9.1. Te gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin prej ose në lidhje me zbatimin e kontratës, do të zgjidhen nga palët miqësisht në frymën e dispozitave të kësaj Kontrate.
- 9.2. Në rast kur nuk arrihet një zgjidhje miqësore, palët do t'i drejtohen Gjykatës kompetente sipas legjislacionit të zbatueshëm.
- 9.3. Kjo Kontratë qeveriset dhe interpretohet nga Ligji i Republikës së Kosovës.

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE

### **Neni 10**

#### **AFATI**

- 10.1 Afati i kryerjes se shërbimit postar do të fillojë nga momenti i pranimi të mallit apo dërgesës në vendin e përcaktuar nga Klienti deri në mbërritjen e tij ne destinacion e Pranuesit.

### **Neni 11**

#### **DISPOZITAT E FUNDIT**

- 11.1. Ndryshimi i përfaqësuesve të palëve kontraktuese nuk sjell ndryshime në kontratë.
- 11.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate, për të cilën palët bien dakord rregullisht, do të bëhet me shkrim.
- 11.3 Dispozitat e Kontratës së veçantë midis palëve, mbizotërojnë Kushtet e Përgjithshme.
- 11.4 Kjo kontratë perpilohet në 2 (Dy) kopje identike ne gjuhen shqipe. Palët pasi u njohen me permbajtjen e saj, e nenshkruajnë atë me vullnetin e tyre te plotë dhe të lirë.